



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
BASHKIA MAT
KRYETARI

Nr. _____ Prot.
_____._____.2020

Burrel, më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: Operatorin Ekonomik: “NELSA ” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **J71601012S**

Adresa: *Tirane, Dajt, DAJT, Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460,
me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1.*

Procedura e prokurimit: “**Kërkesë për Propozim - Mallra**” – Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Numri i referencës së procedurës/ Lotit Nr.1: **REF-58971-05-26-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti Nr.1 “Blerje Ushqime”**, me fond limit për shumatoren e çmimeve për njësi në vlerën: **3 392 (tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH**, Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **1 252 245 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH**, me afat realizimi të marrëveshjes kuadër **12 (dymbëdhjetë) muaj**.

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: **Nr. 32, datë 01 Qershor 2020**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatorin Ekonomik: “NELSA” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **J71601012S**

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera: **2 574.5 (dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë pesë) lekë pa TVSH**.

2. Operatorin Ekonomik: “ERDIS” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **K71804011J**

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera: **2 586.5 (dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e**

gjashtë pikë pesë) lekë pa TVSH.

3. Operatorin Ekonomik: “4 S” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L64425401K**

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera: **2 572** (*dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy*)
lekë pa TVSH

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “4 S” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L64425401K**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “4 S” Sh.p.k për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1 / 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme :

a) *Në rastet e furnizimeve të ngjashme të kryera me institucione shtetërore.*

- *Vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës ku në vërtetim të jetë e përcaktuar koha e furnizimit, vlera e realizuar si dhe vërtetim e realizimit me sukses të kontratës.*

b) *Në rastet e furnizimeve të ngjashme me subjektet private.*

- *Faturat tatimore shitjeje ku të jenë të shënuara saktë datat, artikujt ushqimore, sasitë, shumat si dhe emri dhe nënshkrimi i personit blerës.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur për vërtetimin e furnizimeve të ngjashëm me institucione shtetërore, konstatohet se, në vërtetimin e lëshuar nga institucioni nuk është përcaktuar vlera e realizuar nga ana Juaj.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Raport Analize origjinale ose kopje të noterizuar, lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës, për produktet e ofruara.

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e**

paraqitur, konstatohet se, nga ana Juaj si operator ekonomik pjesëmarrës nuk janë paraqitur Raport Analizat për të gjitha produktet e kërkuara në procedurën e prokurimit me objekt: “Loti Nr. 1: “Blerje Ushqime” por vetëm për 7 prej tyre.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: “NELSA” Sh.p.k, me seli: *Tirane Dajt DAJT Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1*, me numër Nipt-i: **J71601012S**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **2 574.5** (*dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë pesë*) **lekë pa TVSH/** për shumatoren e çmimeve për njësi, **është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5** (*pesë*) **ditëve** nga dita e marrjes/ publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **2 586.5** (*dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë pesë*) **lekë pa TVSH/** për shumatoren e çmimeve për njësi, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **19.06.2020**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

Titullari i Autoritetit Kontraktor